

Parashkollorja



Kërkesat minimale ndaj fëmijëve	4
Regjistrimi	6
Detyrat e parashkollores	7
Lëndët mësimore në parashkollore	10
Për më tepër	13
Kontakti i Udhëheqësisë së shkollave	15

© Gemeinde Glarus

Gemeinde Glarus
Departamenti për Arsimin dhe Familje
Gemeindehausplatz 5
8750 Glarus
www.schule-glarus.ch
Telefoni 058 611 81 61
bildung@glarus.ch




Edicioni i 6-të, 2025

Ky botim është i përkthyer edhe në gjuhën:
Portugeze dhe atë gjermane




Prindër të nderuar

Hyrja në kopsht është një hap i rëndësishëm për fëmijën tuaj dhe për të gjithë familjen. Për ne drejtorët dhe edukatorët e shkollave është shumë e rëndësishme që fëmija juaj të ndihet mirë me ne dhe që të vijë me kënaqësi në kopsht.



Kjo broshurë do t'ju njohë me informacionet e para të rëndësishme. Aty do të mësoni mbi përditshmërinë tonë, do të sqaroheni për detaje të rëndësishme dhe do të merrni këshilla të dobishme. Nëse keni paqartësi, pyetje ose probleme, edukatorët e kopshtit të fëmijës suaj do t'ju vijnë në ndihmë.

Së bashku ne mund të krijojmë një mjedis përkrahës për fëmijën që të rritet dhe të zhvillohet. I Urojmë fëmijës suaj sa më shumë zbulime dhe njohje emocionuese gjatë periudhës së kopshtit. Ju mirëpresim ta kryejmë këtë rrugëtim emocionues së bashku me ju!



Marco Schifferle
Drejtor i Departamentit për Arsimin
dhe Familje Bashkia Glarus



Kërkesat minimale ndaj fëmijëve

Për një fillim të mirë në parashkollorë, kriteret në vazhdim janë shumë të rëndësishme.

Fëmija duhet që...

- /// të shkojë i pavarur në tualet.
- /// të i lajë duart dhe ta pastrojë hundën vetë.
- /// të vishet dhe të zhvishet mundësishtë vetë.
- /// të mundë të ndahet nga prindërit.
- /// tashmë të ka sjellje shoqërore me fëmijët tjerë.
- /// të ka aftësi motorike themelore.
Motorika: vrapimi, të ngjitet/hipë,
të ngjitet shkallëve.
Motorika e imët: të vizatojë, të ngjesë, të prejë.
- /// të është i kujdesshëm me lodrat, ta dijë, që pas lojës, lodrat duhet të kthehen në vendin e vet.



Prindërit migrantë

Ju prindër që gjuhë amtare keni një gjuhë të huaj, mundë të ia lehtësoni fillimin në parashkollore fëmijës Tuaj duke ia mundësuar mësimin e një fjalori elementar të gjuhës gjermane.

Mënyra më e mirë që ta arrini këtë është integrimi i fëmijës në shoqëri me zvicëranët, shkuarja në «Grupin e Lojës» (Spielgruppe) apo edhe shkuarja në një kurs të gjuhës për fëmijë.



Regjistrimi

Regjistrimi në parashkollore

- ! Fëmija, i cili deri më 31 korrik i mbushë 4 vjet, duhet ta fillojë shkollimin.
- ! Shkuarja në parashkollore për dy vite është e obliguar.

Kështu mundë ta ndihmoni fëmijën Tuaj:

- ! Rruga për në shkollë. Më së miri është, që para fillimit të parashkollorës, të ecni me fëmijën deri aty, të ia mësoni rrugën dhe të ia tregoni rreziqet e komunikacionit.
- ! Fëmijët e kësaj moshe nuk dijnë ta ndajnë kohën dhe gjatë rrugës shumëherë habiten duke shikuar dhe zbuluar gjëra, prandaj përcjelleni prej shtëpisë me kohë.
- ! Bisedoni me fëmijën se deri ku dëshiron ta përcjellni, dhurojani besimin Tuaj.
- ! Vetëm në raste të jashtëzakonshme mundë ta sillni fëmijën me makinë. Përndryshe rruga për në parashkollore më së miri është që të bëhet në këmbë në çfardo moti.



Detyrat e parashkolltores

Me hyrjen në parashkollore, për fëmijën Tuaj fillon një periudhë e re jetësore. Njohja me fëmijë tjerë, njohja me mësuesën dhe integrimi në grupin e fëmijëve.

Në parashkollore fëmija Juaj në tërësi do të promovohet në tri kompetencat e arsimimit:

- /// Kompetenca metodike
- /// Kompetenca personale
- /// Kompetenca sociale

/// Kompetenca metodike

Kompetenca metodike do të thotë të kuptosh, të vlerësosh dhe të veprosh siç duhet sipas informacionit.

Fëmijët e zgjerojnë diturinë e tyre në të gjitha sferat e jetës, në proceset e natyrës dhe kulturës, në gjuhë, teknikë, matematikë dhe krijim. Ata fillojnë të i dallojnë ngjajshmëritë në mes të gjërave dhe të i lidhin ato me përvojën e tyre. Parashkollorja u ofron fëmijëve mundësinë e mësimit duke praktikuar dhe eksperimentuar në procese të ndryshme, njohjen dhe punën me materiale dhe mjete të ndryshme dhe ta tregojnë e ta përdorin përvojën e tyre.



/ Kompetenca personale

Kompetenca personale do të thotë marrja e përgjegjësisë për vetveten dhe sjellja e përputhshme me rrethanat.

Duke bërë zgjidhje në rast të grindjes, duke konstruktuar një veturë me lego ose duke punuar ndonjë punë dore, fëmijët fitojnë gjithnjë e më shumë pavarësi. Ata mundohen, të gjejnë zgjidhje vetë dhe të provojnë gjëra të reja.

Ata mësojnë të gjykojnë vetë si dhe mjedisin e rrethin ta njohin me interesim dhe kureshtje. Në parashkollorë fëmijët i mbështesim në zhvillimin e personalitetit të tyre.

Poashtu i inkurajojmë, që të merren/të mendojnë me vetveten, me trupin e tyre dhe me botën. Parashkollorja u mundëson fëmijëve ta përjetojnë ndjenjën e të pasurit sukses gjë kjo që ua shton dëshirën për të mësuar, i motivon dhe ua forcon vetëbesimin.

/ Kompetenca sociale

Kompetenca sociale e tregon aftësinë e fëmijës se si gjindet dhe jeton në shoqëri dhe në grup. Poashtu tregon se sa është i vetëdijshëm fëmija për përgjegjësit e tijë dhe se a i trajton ato në përputhshmëri me rrethanat.

Ata mësojnë të integrohen në grup, të kanë konsideratë ndaj njëri-tjetrit, të i njohin dhe të ju përmbahen rregullave të bashkëjetesës. Mbase klasët tona janë multikulturore, fëmijët mësojnë që të janë të hapur edhe me njerëzit nga vendet e ndryshme. Poashtu fëmijët mësojnë të bisedojnë në mes vete dhe të i zgjidhin edhe konfliktet.



Lëndët mësimore në parashkollorë

Për ta shtytur nivelin e zhvillimit të fëmijës në mënyrë të përshtatshme, nevojiten edhe lëndët mësimore. Këto lëndë mësimore nuk kanë orar të një ore mësimore, mirpo ato rrjedhin në përditshmërinë e parashkollorës.

Gjuha

Duke ndëgjuar dhe treguar përralla dhe tregime, me anë të vargjeve dhe këngëve mësojnë të i shqiptojnë fjalët korrekt. I mësojnë termet kronologjike dhe hapsinore dhe përdorimin e tyre. Mësojnë të punojnë me mjetet e shkrimit.

Matematika

Sortimi, krahasimi, rradhitja dhe numrimi i gjërave të përditshme. Të i njohin format dhe shifrat, ta dijnë sasinë deri në 10, të dijë të orientohet në hap-sirë (poshtë, lartë, majtas, djathtas).

Natyra, njeriu dhe shoqëria

Ta njohin orarin, ditët e javës, muajt dhe stinët e vitit. T'i praktikojnë rregullat e para në komunikacion. Të janë të ndërgjegjshëm ndaj natyrës dhe mjedisit. Ta njohin biodiversitetin vendas.



Njohja e profesioneve, njohja me mjetet informative dhe me rrënjët kulturore dhe tradicionale të njerëzve. Njohja me punët në dhe rreth shtëpisë.

Puna e dorës

Duke shijuar eksperimentimin me materiale të ndryshme, dhe përceptimi me pesë shqisat. Ngjallja e kreativitetit, realizimi i ideve dhe mësimi i të punuarit adekuat me materialet. Ngjyrat dhe format të njohin. Mjetet, teknikat dhe elementet e ndryshme të punës të i provojnë.

Muzika

Të ua zgjojmë dëshirën për këndim dhe muzikë. Ta njohin ritmin në vargje dhe këngë. Të lëvizin sipas zhurmës, zërit dhe ritmit.

Lëvizja dhe sporti

Të i provojnë mundësitë e ndryshme të lëvizjes si ecja, kërcimi, ngjitja/hipje, balansimi, të sillen, të rrotullohen, gjuajnë dhe të luajnë. Ta ngopin dëshirën natyrale të lëvizjes dhe njëkohsishtë bëjnë përvoja të shumëanshme të dijes.



Ndërdisciplinore

Ruajtja e shëndetit

Njohja me gjërat ushqimore dhe kujdesi i pastërtisë së trupit.

Loja e lirë

Loja si nevojë themelore e fëmijës, ka vend të rëndësishëm në parashkollorë. Duke luajtur fëmija zhvillohet dhe bëhet i shëndetshëm. Pa e ditur ushtron fantazinë dhe disponimin, shqisat, motorikën, shkathtësinë dhe zotërimin e trupit të vet. Kur është koha e lojës, fëmija vetë zgjedh vendin dhe materialin e lojës.

Është me rëndësi që fëmija të zgjedh se a do të luaj vetëm apo me të tjerët, sepse ai e din a ka nevojë për qetësi apo të kontaktojë me të tjerët. Veçantërisht në kohën e sotme, është me rëndësi ti qasemi lojës më shumë, në mënyrë që ti largojmë fëmijët nga pasiviteti.

Gjatë lojës fëmija e përpunon përvojën e mirë por edhe atë që e shqetëson. Fëmija në lojë i imiton edhe situatat e jetës së përditshme, në këtë mënyrë ai i ripërjeton dhe i përpunon situatat e ndryshme.



Për më tepër

Kujdesi shëndetsorë

- ▮ Tre herë në vit një instruktor/e i/e kujdesit dentar viziton kopshtin.
- ▮ Në vitin e parë të kopshtit, fëmijët, sipas dëshirës, i nënshtrohen një kontrolli stomatologjik.
- ▮ Fëmijëve u jepet mundësia që gjatë kohës në kopsht të marrin pjesë në një test mjekësor të shikimit dhe dëgjimit.
- ▮ Për kontrollin gjashtëvjeçar, prindërit duhet ta regjistrojnë vetë fëmijën te mjeku i familjes ose pediatri.

Arsimi i sigurisë rrugore

- ▮ Një herë në vit polici i trafikut e viziton parashkollorën dhe ushtron me fëmijët situata të ndryshme të komunikacionit.
- ▮ Mbjajtja e rripit të parashkollorës është e obliguar.

Sigurimi për aksident

Në rast aksidenti në apo gjatë rrugës për në parashkollorë ose edhe gjatë një mbledhjeje në parashkollorë, sigurimi bazë i sigurimit shëndetsor i mbulon kostot. **Sigurimi është qështje e prindërve.**



Leja për pushime

Parashkollorja, sipas Rregullorës për Mungesa dhe Pushime të Nxënësve, mundet të japë vetëm 4 herë nga gjysmë dite pushim në vit. Për pushime që zgjasin deri në 10 herë nga gjysmë dite, vendos Udhëheqësija e Shkollës. Dispensimet më të gjata duhet të dorëzohen në Departamentin e Arsimit dhe Familjes. Formulari përkatës mund të merret tek mësuesit, sekretaria e shkollës ose në sportelin online të shkollës (www.schule-glarus.ch).



Kontakti i Udhëheqësisë së shkollave

/ Shkolla Glarus-Riedern

Kindergarten Erlen, Glärnisch
.....
Lorenzo Conte,

Udhëheqësi i shkollës
lorenzo.conte@glarus.ch
Telefoni 058 510 62 05

Sonja Grütter, Sekretariat
sonja.gruetter@glarus.ch
Telefoni 058 510 62 04

Kindergarten Löwen, Riedern

.....
Alice Dürst,
Udhëheqësja e shkollës
alice.duerst@glarus.ch
Telefoni 058 510 62 02

Andreas Venegoni, Sekretariati
andreas.venegoni@glarus.ch
Telefoni 058 510 62 01

/ Shkolla Ennenda

Kindergarten Ennenda
.....
Eva Egli

Drejtoresha e shkollës
eva.egli@glarus.ch
Telefon 058 510 62 13

Manuela Schneider, Sekretariati
manuela.schneider@glarus.ch
Telefoni 058 510 62 14

/ Shkolla Netstal

Kindergarten Netstal
.....
Pascal Nigg,

Zëvendësdrejtor
pascal.nigg@glarus.ch
Telefon 058 510 62 10

Evelin Merlo, Sekretariati
evelin.merlo@glarus.ch
Telefoni 058 510 62 11



